

VENDIM
Nr. 397, datë 30.6.2021

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR PERSONAT JURIDIKË
NËNKONTRAKTORË, QË KRYEJNË OPERACIONE HIDROKARBURE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e rregullave të detajuara, që do të zbatohen për personat juridikë nënkontraktorë, në kuptim të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, të cilët, direkt ose indirekt, kryejnë operacione hidrokarbure në përputhje me legjislacionin në fuqi për hidrokarburet, ku përfshihen kërkimi dhe prodhimi, si dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit 2, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

2. Përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 4, të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Aktivitet thelbësor i një operacioni hidrokarbur**”, një ose disa operacione hidrokarbure të realizuara nga personat juridikë nënkontraktorë, kur niveli i kontributit të faturimeve të këtij personi juridik në totalin e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar është jo më pak se 25 (njëzet e pesë) %;

b) “**Persona të lidhur**”, i njëjti kuptim i dhënë nga neni 2, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

c) “**Operacionet hidrokarbure**”, të gjitha operacionet dhe çdo operacion që lidhet me kërkimin, vlerësimin e një zbulimi, zhvillimin, nxjerrjen, prodhimin, ndarjen e trajtimin, grumbullimin, transportimin dhe shitjen ose disponimin e hidrokarbureve deri në pikën e eksportit ose në një pikë lëvrimit në Shqipëri, për të cilën është rënë dakord, ose në pikën e hyrjes në një rafineri dhe përfshin operacionet e përpunimit të gazit natyror, por nuk përfshin operacionet e përpunimit të hidrokarbureve, të cilat janë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për hidrokarburet.

3. Në rastin kur shpenzimet për operacionet hidrokarbure të faturuara ndaj personit të autorizuar nga nënkontraktori janë jo më pak se 25 (njëzet e pesë) % e totalit të shpenzimeve për operacionet hidrokarbure, nënkontraktori ose nënkontraktorët u nënshtrohen dispozitave në fuqi të ligjit nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, dhe paguajnë tatim mbi fitimin në normën tatimore 50 (pesëdhjetë) %. Llogaritja e shpenzimeve për operacionet hidrokarbure, nga nënkontraktori për kontraktorin, bëhet mbi bazën e vlerës totale në lekë të faturave të lëshuara nga nënkontraktori pa TVSH. Nëse vlera e shpenzimeve pa TVSH e llogaritur si më sipër përbën jo më pak se 25 (njëzet e pesë) % të totalit të shpenzimeve të kontraktorit, nënkontraktori tatohet me normën tatimore 50 (pesëdhjetë) % për këtë pjesë të aktivitetit apo të veprimtarisë së tij.

4. Administrata tatimore, në bashkëpunim me AKBN-në, analizon përputhshmërinë e marrëveshjeve dhe të kontratave të lidhura ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit me parashikimet/rregullimet e legjislacionit në fuqi për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur dhe tatimin mbi të ardhurat, me qëllim identifikimin e rasteve kur synohet shmangia nga nënkontraktori i pagesës së tatimit, sipas normës tatimore të përcaktuar në ligjin nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

5. Në rastet kur, në përputhje me pikën 4, të këtij vendimi, evidentohet se kontraktori dhe/ose nënkontraktorët kryejnë një ose një sërë veprimesh apo transaksionesh direkte apo indirekte, që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, veprimi apo transaksioni rikarakterizohet nga administrata tatimore dhe detyrimi i ri tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat në fuqi për vlerësimin tatimor alternativ, të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 153/2020, “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

6. Vendimi përfundimtar për normën tatimore të aplikueshme për nënkontraktorët, në zbatim të pikës 5, të këtij vendimi, merret nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bashkërendim me drejtorinë rajonale tatimore, ku janë të regjistruar personat juridikë nënkontraktorë.

7. Me qëllim zbatimin e këtij vendimi, administrata tatimore bashkëpunon e bashkërendon punët me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), sipas funksioneve dhe veprimtarisë së tyre, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe